



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Dhjetor 2020

Nr: 41

VENDIM

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATIT ZJ. VASILIKA STILJAN TRAJKO NGA LISTA SHUMEMËRORE E
PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË MALIQ, NË
ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË
PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE
PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 5920/1 prot., datë 02.12.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Aleksandra Bardhi Kinolli, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Maliq, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 28, zj. Vasilika Stiljan Trajko.

Me shkresën nr. 2246 prot., datë 09.12.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Maliq, zj. Vasilika Stiljan Trajko, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia e Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0058 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Vasilika Stiljan Trajko, në këshillin e bashkisë Maliq, rezulton se: Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga "Kolefski" në "Trajko".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2419 prot., datë 16.12.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2418 prot., datë 16.12.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Vasilika Stiljan Trajko, në Këshillin e Bashkisë Maliq, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Maliq, zj. Vasilika Stiljan Trajko.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 12753/1 prot., datë 18.12.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Vasilika Stiljan Trajko, në këshillin e bashkisë Maliq, e cili rezulton me status e padënuar nga gjykatat shqiptare.



Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafi 2, Kreu V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Vasilika Stiljan Trajko, në këshillin e bashkisë Maliq, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Maliq.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Zj. Vasilika Stiljan Trajko, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Maliq, e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Maliq, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Vasilika Stiljan Trajko, e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 38 prot.

Tiranë, më 5.1.2020

